

International Scientific Conference

The economic stability of the Balkan's countries and integration challenges

03 June, 2017@ AAB College, Pristina – Republic of Kosovo

BOOK OF ABSTRACTS

Organized by:



in partnership with:



<http://konferencat.aab-edu.net/icbes2017/en/>

Bordi Shkencor:

Prof. ass. dr. Shaip Bytyçi – Kryetar i Bordit Shkencor

Prof. ass. dr. LulzimTafa - Rektor i Kolegjit AAB

Prof. Assoc. dr. Ervin Myftaraj - Universiteti Aleksandër Moisiu - Durrës

Prof. ass. dr. Hasan Saliu – prorektor për kërkim shkencor, Kolegji AAB

Prof. dr. Zorica Bozinovska - Lazarevska, Universiteti sv.Kiril i Metodij, Fakulteti Ekonomik-Shkup

Prof. asoc. dr. Juljeda Gërxi - Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës

Prof. ass. dr. Xhavit Rexhaj - Kolegji AAB

Dr. sc. Pleurat Mustafa - Kolegji AAB

Dr. sc. Naim Ismajli - Kolegji AAB

Prof. asc. dr. Nazmi Iballi - Kolegji AAB

Komiteti Organizues:

Kosovare Ukshini

Zija Rexhepi

Medaim Hashani

Ylber Prekazi

Donat Rexha

Brikena Berisha

Roberta Bajrami

Fidan Qerimi

Naile Demiri

ROLI I REKLAMËS NË INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

MA. Adelina Gashi

Kolegji AAB

E-mail: adeliana.gashi@aab-edu.net

Abstrakt

E ndodhur në Evropën Juglindore, ekonomia e Kosovës është pjesë e integritimeve ekonomike të këtij rajoni, të cilat ofrojnë mundësinë e zgjerimit të tregut në një hapësirë mjaft të gjerë. Qëllim në vete tashmë është rritja e konkurrencës së kësaj ekonomie, duke rritur kapacitetin e saj eksportues, për të zvogëluar deficitin tregtar që Kosova aktualisht ka. Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit, Kosova ofron një sërë përparësish komparative si: popullsi të re dhe mjaft mirë të kualifikuar, ku mosha mesatare e saj është mjaft e re, resurse natyrore, kushte të volitshme klimatike, infrastrukturë të re, politika fiskale me taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozita gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-s dhe në atë të Bashkimit Evropian, që e bëjnë Kosovën një mjedis atraktiv dhe të favorshëm për investuesit e huaj. Si rezultat i gjithë kësaj Kosova nisi një fushatë mediatike me rastin e 4-vjetorit të pavarësisë së saj, e cila kishte për qëllim promovimin e potencialeve të Kosovës para investitorëve të huaj. Mesazhi që përcillet "Kosova, shteti më i ri në botë -evropianët e rinj", përmes spotit i cili fton të tjerët t'i bashkohen festës së shtetit më të ri në botë. Për realizimin e këtij punimi janë gërshtuar të dhënat dytësore bibliografike si literatura bashkëkohore dhe materialet prezantuese dhe promovuese në internet. Hipoteza synon të sqarojë çfarë lloj promovimesh janë bërë apo çfarë potenciali mund të shohin të huajt apo ndoshta një pjesë e njerëzve do të impresionohen nga kjo dhe do të vijnë në Kosovë?

Fjalë kyç: reklama, investime, Kosova, investime të huaja direkte, CEFTA.

ESTIMATING POTENTIAL OUTPUT AND THE OUTPUT GAP IN KOSOVO

PhD Albulenë Kastrati

AAB College, Pristina

Email: albulenekastrati@gmail.com

Abstract

This paper makes the first attempt to estimate potential output and the output gap in Kosovo, for the period 2002 to 2011. Given the structural changes and relatively short time-series data, this paper utilises a Kalman filter approach, whose complex structure is more appropriate in the case of transition countries that has undergone structural changes and have relatively short time-series. This approach is novel for Kosovo case. Furthermore, an added value of this paper is a thorough interpretation of the Kalman filter technique in business cycle analysis.

This study finds that the Kosovo economy was performing below its potential from the beginning of the period up to 2008, reaches an equilibrium during 2009 and performs with low levels of above potential output from 2010 onwards. The paper concludes that the fiscal policy is the main driver of the business cycle in Kosovo.

Keywords: *Kosovo, Potential Output, Output Gap, Kalman Filter*

THE IMPACT OF REMITTANCES ON POVERTY IN KOSOVO – A COUNTERFACTUAL SCENARIO ANALYSIS

Dr. Arbëresha Loxha
AAB College

Abstract

Kosovo is one of the poorest countries in Europe, with 29.7 percent of the Kosovar population living below the national poverty line, and an estimated 10.2 percent reported as extremely poor. Migration and remittances have been an effective mechanism for mitigating poverty, as well as a coping mechanism for disadvantaged households with no or little employment and earning opportunities. The high dependence of households on remittances suggests that poverty rates would be much higher without the safety net provided through migration and remittances. This paper analyzes the impact that remittances and migration have on the poverty in Kosovo, in a hypothetical case, without remittances and migration using data from the Household Budget Survey 2011. The study developed counterfactual consumption estimates for remittance recipient households through the use of econometric estimations to predict the consumption of households in the case of no remittances. Due to the potential presence of selection bias, the paper uses a two-stage Heckman-type selection procedure which suggests that there is no selection bias. This estimation enables comparing the poverty rates, observed and predicted, in Kosovo and also across the regions. The results support the hypothesis that remittances increase the consumption of recipient households. The poverty rate would be higher for a considerable proportion of households in the case of no remittances. The poverty rates would increase, particularly in rural areas.

Keywords: *Migration, Remittances, Poverty, Kosovo, Counterfactual analysis*

ECONOMIC DEVELOPMENT THROUGH PROJECTS AND FUNDS FROM INTERNATIONAL ORGANIZATIONS

Msc. Ariola Harizi

Double S -Tax and Accounting Studio

E-mail: ariolaharizi@hotmail.com

Msc. Myfarete Malasi

Municipality of Durres-Department of Tax and Fees

E-mail: m.malasi@yahoo.it

Abstract

The role of funds and projects provided by International Organizations to the economic development for our country over the years is one of the objectives of this paper. Firstly, will explain their goals and the way how these organizations operate, what kind of agreement they have with our country, and the conditions, in order to take benefits from them. As we know the main role and the great support they give to the economic development of the country, is very important for us. In this paper, we will analyse approved projects, their problems in implementing them, and the results, also the effects of the implementations. Are these funds used effectively? How qualitative are these projects? How is predicted to be the relationship of our country, with these organizations in the future? This research is based due to qualitative and quantitative research, information collected from relevant national and international institutions, references of various contemporary books, the materials obtained from official websites of these organizations and published reports by them, in order to study the progress and the results that they have in Albania.

Keywords: funds, projects, economic development, international organizations, Albania.

PAPUNËSIA NË KOSOVË DHE NË DISA VENDE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Arlinda Azemi

Kolegji AAB

E-mail: arlinda.zeneli@gmail.com

Abstrakt

Përpos që është shteti më i ri në rajon, Kosova është edhe njëra nga shtetet më të vogla, si për nga madhësia ashtu edhe nga ndikimi i saj ekonomik në rajon. Sipas gjendjes momentale në Kosovë, ajo ka papunësi të lartë dhe pjesëmarrje të ulët në tregun e punës, posaçërisht ndër të rinjtë dhe femrat. Vonesat e Kosovës në tranzicion dhe pasojat e luftës kanë krijuar vështirësi në ndërtimin e një ekonomie të shëndoshë. Pasi që papunësia në Kosovë është pasojë e shkallës së trashëgimisë së zhvillimit ekonomik, problemi kryesor është krijimi i një politike të shëndoshë makroekonomike që do të mund të sigurojë një kornizë dhe kushte për funksionimin e tregut të punës në vend, i cili është në gjendje të mbajë vendet ekzistuese të punës dhe të krijojë vende të reja të punës. Tregjet e punës në vendet e rajonit (Ballkanin Perëndimor) vazhdojnë të ndajnë si karakteristikë të përbashkët shkallën e lartë të papunësisë, sidomos tek të rinjtë dhe femrat, si dhe papunësinë afatgjatë. Punimi ka për qëllim për të vënë në pah karakteristikat e tregut të punës në Kosovë, politikat që përdor vendi ynë në uljen e papunësisë, gjithashtu që të prezantojë një analizë krahasuese të të dhënave lidhur me papunësinë mes Kosovës dhe disa vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në punim do të përdoren të dhënat sekondare dhe kryesisht do të mbështeten në teori ekonomike, të dhëna statistikore, metoda krahasuese etj. Si përfundim themi se papunësia në Kosovë paraqet një problem mjaft kompleks dhe të ndërlikuar ekonomik, shoqëror, social, psikologjik, politik etj., pra janë probleme me kosto të mëdha ekonomike dhe sociale.

Fjalë kyç: *shtet, papunësi, tranzicion, rajon, zhvillim ekonomik, kosto.*

SIPËRMARRJA DHE RËNDËSIA E SAJ NË ZHVILLIMIN EKONOMIK

Msc. Atifete Thaqi

Universiteti “Haxhi Zeka” - Pejë

E-mail: atifete.th@hotmail.com

Abstrakt

Sipërmarrja ka rolin kyç në zhvillimin e ekonomisë së tregut dhe zhvillimin e ekonomisë së një vendi në tërësi. Për shumë njerëz, zotërimi i një biznesi të vogël, për shkak të pavarësisë së madhe dhe të ardhurave financiare që sjell, është tepër joshës. Shumë njerëz e kanë pasur ëndërr të jenë sipërmarrës, por shumë prej tyre ngurrojnë ta realizojnë këtë ëndërr, duke menduar se nuk kanë arsimimin, përvojën apo paratë e duhura. Sipërmarrësit marrin mbi vete edhe rreziqet për të arritur deri te sukcesi i dëshiruar gjatë drejtimit të aktiviteteve në bizneset e tyre. Sipërmarrja është aftësia e një individi për t'i kthyer idetë në veprime konkrete. Ajo përfshin krijimtarinë dhe marrjen përsipër të rrezikut të llogaritur, aftësinë për të planifikuar dhe menaxhuar projektet, në mënyrë që të arrihen objektivat e vendosura. Një sipërmarrës është një person i cili është në gjendje për të krijuar mundësitë e ndërtimit të një gjëje nga asgjëja, duke motivuar veten dhe të tjerët për të arritur qëllimin e tij. Motivi i tij është për të fituar me prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave ose shërbimeve sociale të dobishme. Brenda vitit ne kemi shumë sipërmarrës të rinj të cilët provojnë mundësinë e krijimit dhe mbajtjes në jetë të bizneseve të reja. Këta sipërmarrës i gjejnë edhe në mesin e studentëve, të cilët shquhen për aftësitë dhe guximin për të marrë përgjegjësi në udhëheqje të bizneseve, kur dihet se risku është i madh.

Fjalë kyç: *sipërmarrje, sipërmarrës, ekonomi e tregut, mjedis biznesor, sfidë.*

SISTEMI ARSIMOR NË MAQEDONI

“FURGONE PRODUCTION”

Dr. Besime Ziberi

Kolegji AAB

E-mail: besime.ziberi@aab-edu.net

Audenta Haliti

audenta.haliti@aab-edu.net

Abstrakt

Teoritë endogjene të rritjes ekonomike, fuqinë punëtore të shkathtë (të kualifikuar), e konsiderojnë si një bartës kryesor të progresit dhe rritjes ekonomike. Politikat arsimore në RM e kanë sjellë vendin në mbiofertë të të diplomuarve universitarë, duke krijuar një ekstrenalie negative të llojit “*furgone production*”. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të elaborohen trendet e të diplomuarve universitarë të kategorizuar si “*soft*”, “*medium*” dhe “*semi skilled*” dhe normës së punësimeve vs. papunësisë në rastin e Maqedonisë. Duke shfrytëzuar të dhënat sekondare nga Enti i Statistikave Shtetërore dhe indikatorët e Fondit Monetar Ndërkombëtar, elaborohen trendet dhe tendecat e të diplomuarve universitarë për periudhën kohore 1991-2016 dhe norma e punësimeve vs. papunësisë sipas nivelit të arsimit. Sipas analizave dhe gjetjeve vijmë në konkluzion mes të tjerave se politika arsimore e zbatuar në rastin e Maqedonisë është e papërshtatshme në drejtim të përmbushjes së kërkesave për profesione reale në tregun e punës. Kjo politikë ka shkaktuar efektin e “mungesës” për profile të caktuara në tregun e punës. Rekomandohet që profilet që krijon arsimi, konkretisht rritja e numrit të diplomuarve të nivelit universitar (veçanërisht), të ketë ndikim pozitiv në rritjen e punësimeve dhe në zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi, të orientohet në drejtim të kërkesës për profesione reale në tregun e punës.

Fjalë kyç: *arsim, rritje ekonomike, të diplomuar universitarë, treg i punës*

INDUSTRIA E SIGURIMEVE SI PJESË E QËNDRUESHMËRISË EKONOMIKE TË KOSOVËS

Besnik Zekaj, PhD Cand.

Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë

E-mail: besnik.zeka@unhz.eu

Abstrakt

Kosova si shtet i ri po ballafaqohet me sfida të ndryshme në zhvillimin e saj ekonomik, duke kaluar kështu nëpër një rrugë jo të lehtë. Me një ekonomi të rrënuar nga e kaluara nën okupim dhe me barriera që edhe sot janë aktuale si pasojë e së kaluarës, Kosova me shumë vështirësi po integrohet në mekanizmat regional dhe ndërkombëtarë. Një ndër segmentet e zhvillimit ekonomik të vendit është edhe industria e sigurimeve, e cila po ashtu ka kaluar në një rrugëtim për t'u konsoliduar.

Kompanitë e sigurimit kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe financiar të një vendi, duke ua mundësuar qytetarëve, ndërmarrjeve dhe vetë shtetit, të bërit biznes në mënyrë më të sigurt si dhe një investim në kursime për një stabilitet financiar. Kompanitë e sigurimit janë investitorë të rëndësishëm përmes tregut financiar, si përmes investimit në letra me vlerë dhe aktivitete tjera ekonomiko-financiare. Sigurimet kryejnë një funksion të rëndësishëm shoqëror. Sa më e madhe të jetë përqindja e të siguruarve (mbajtës të polisave), aq më pak do të shpenzohet buxheti i shtetit për të kompensuar dëmet ekonomike për biznese të ndryshme dhe për persona fizikë, p.sh. kompensimet nga ndonjë katastrofë natyrore. Andaj, mund të themi se industria e sigurimeve luan një rol mjaft të rëndësishëm në qëndrueshmërinë ekonomike të vendit tonë.

Fjalë kyç: *qëndrueshmëri ekonomike, industri e sigurimeve, mjedis financiar.*

BALLKANI PERËNDIMOR DHE TRENDET AKTUALE TË GLOBALIZIMIT

MA. Bujar Bujupi

Kolegji AAB

Email: bujar.bujupi@aab-edu.net

Abstrakt

Ekonomia globale sa vjen e bëhet më dinamike, më e integruar dhe e zhvilluar duke përfshirë në korpusin e vet ekonomitë e vendeve të ndryshme në një proces të vetëm, me përfshirjen edhe të ekonomive të rajonit të Ballkanit Perëndimor, njohur ndryshe si një rajon trazirash, i karakterizuar me jostabilitet politik, ekonomik, papunësi dhe korrupsion. Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i gjendjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor, sfidat drejt integritit karshi trendeve globale dhe përpjekjet e qeverive për zhvillim ekonomik, sa kanë arritur ato të krijojnë mjedis të qëndrueshëm dhe konkurrues, krijim të kushteve për investime të huaja, sa kanë bërë këto qeveri drejt integritit dhe bashkëpunimit rajonal e më gjerë?

Të gjeturat dëshmojnë nevojën për vazhdim të reformave drejt nxitjes ekonomike, krijim të vendeve të reja të punës dhe përmirësim të gjendjes sociale, përmes zbatimit të politikave dhe strategjive për një zhvillim të qëndrueshëm. Siguria dhe stabiliteti rajonal, bashkëpunimi rajonal dhe integriti në tregjet globale është i rëndësishëm dhe vizion për të ardhmen. Politikbërësit dhe vendimmarrësit duhet të fokusohen seriozisht për mjedis të përshtatshëm dhe konkurrues, tërheqje të investimeve të huaja dhe mbrojtjen e tyre, zhvillim të kapitalit njerëzor, arsimim dhe edukim, zhvillim të ndërmarrësisë, inovacion.

Fjalë kyç: *ekonomi, globalizëm, Ballkan Perëndimor, zhvillim ekonomik, integritim, edukim, inovacion.*

NDIKIMI I EKONOMIVE BUJQËSORE FAMILJARE NË BPV

MA Driton Sejdiu

Kolegji AAB

E-mail: driton.sejdiu@aab-edu.net

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është që të njihemi me BPV-në (bruto produktin vendor), mënyrat e matjes së tij, çka përfshihet në të, të metat që ka ky tregues dhe ekonomitë më me ndikim që formulojnë këtë tregues, duke na e bërë më të lehtë që ne të arrijmë pikësynimin tonë në këtë punim, që të shprehim në mënyrë më të detajuar “Ekonomitë familjare bujqësore” dhe ndikimin që ka ky sektor në BPV dhe rrjedhimisht në mirëqenien e vendit. Në bazë të nivelit të produktit të përgjithshëm (BPV) mund të gjykojmë për gjendjen e ekonomisë në tërësi dhe për dinamikën e saj.

Qeveritë, bizneset dhe organizatat e ndryshme mbështeten shumë në BPV, pritjet dhe analizat e tyre i mbështesin pikërisht mbi të dhënat e tij. Strumbullar studimi i këtij punimi janë “Ekonomitë familjare bujqësore”, dhe rëndësia e tyre në ekonominë e vendit. Por, për të shprehur rëndësinë që kanë këto ekonomi, ne morëm një tregues që e mbështet teorinë tonë dhe ky është BPV. Në këtë tregues vërtetohet se sektori i bujqësisë është një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë së vendit dhe se ndikimi i tij në BPV është shumë i theksuar dhe është një ndër zërat më të rëndësishëm për nga vlera që përfaqëson.

Rëndësia e këtij sektori: Bujqësia merr pjesë në BPV me afro 12% për vitin 2012, apo 616 mil. euro e prodhimet bujqësore përbëjnë afro 16% të eksporteve të përgjithshme. Ky sektor, gjithashtu siguron rreth 25 % të punësit të përgjithshëm e kryesisht në sektorin joformal. Pra, kemi të bëjmë me një ndër sektorët më të rëndësishëm të vendit, e duke ditur potencialet e vendit tonë, mund të themi edhe me më të rëndësishmin e së ardhmes.

Fjalë kyç: *BPV, ekonomi familjare bujqësore, mirëqenie, potencial vendor.*

THE INTERNAL CONTROLS EVALUATION

MSc. Elva Uruçi

University of Elbasan, Albania
E-mail: elvazeneli@yahoo.com

MSc. Selma Kaçaniku

University of Durrës, Albania
selma-kacaniku@hotmail.com

Gani Zeneli

The directorate of standards, General police directorate, Albania
E-mail: gani.zeneli@asp.gov.al

Abstract

This research is a summary of the systems that are frequently used by the business entity to implement and evaluate internal controls and is seen together with an example of projects that are implemented at the end for temperance, self-control through agreements and procedures (CSA). The CSA methodology is used in the beginning of the process, also in the process of identifying the key business processes and their risk. These processes and controls are made to show what must be done to avoid the risk and are explained how the feedback from the CSA project results as a recommendation that promotes internal control. Some of the benefits that result from the CSA, including increased profitability for the company, objectives, developing a sense of the employees responsible of internal control, early detection of risk and increase the effectiveness of the control units are also discussed in this paper.

Keywords: *Internal control, self-control agreements, COSO system, CSA, company.*

PËRLLLOGARITJA E KOSTOS MESATARE TË PONDERUAR TË KAPITALIT (WACC) PËR SEKTORIN E TELEKOMIT NË KOSOVË

Enver Bajcinca

Kolegji AAB

E-mail: enver.bajcinca@aab-edu.net

Abstrakt

Rëndësia dhe dobia e koston mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC) si mjet financiar, si për investitorët edhe për kompanitë, është e mirëpritur në mesin e analistëve financiarë. Përlllogaritja e WACC-së është e rëndësishme për kompanitë që të marrin vendimet e tyre investuese dhe të vlerësojnë projektet me rreziqe të njëjta dhe të ndryshme. Për të kalkuluar shkallën e rëndësisë si vlera e tanishme neto dhe vlera ekonomike e shtuar nevojitet të gjendet WACC-ja. Gjithashtu është e rëndësishme për investitorët për arritjen e objektivave të kompanisë.

Në disa sektorë që kanë karakteristikat e monopolit natyror, siç mund të jenë sektori i energjisë, telekomunikacionit etj., përcaktimi i WACC-së është një obligim për operatorët e sektorëve përkatës, të cilët vendosin çmimet dhe projektojnë të ardhurat për të mbuluar kostot e aktiviteteve të veta. Deri më tani nuk ka pasur ndonjë përlllogaritje të nivelit të WACC-së për sektorin e telekomit nga institucionet shtetërore. Ky punim ka për qëllim përcaktimin e WACC-së për sektorin e telekomit në Kosovë. Kufizimi i këtij punimi është mungesa e disa të dhënave përkatëse për Kosovën për të llogaritur koston mesatare të ponderuar të kapitalit, për këtë arsye është përdorur metoda benchmark. Bazuar në përlllogaritjet e bëra në punim, niveli optimal i koston mesatare të ponderuar të kapitalit në sektorin e telekomit në Kosovë rezulton të jetë 12%. Vlerë e shtuar e këtij punimi është përlllogaritja e WACC-së për herë të parë në nivel sektori në Kosovë.

Fjalë kyç: *WACC, telekom, Kosovë, normë, përlllogaritje.*

IDENTIFIKIMI I FAKTORËVE QË NDIKOJNË NË PRODUKTIVITETIN NË PUNË

Erblina Pira

Kolegji AAB

erblina.pira@aab-edu.net

Abstrakt

Produktiviteti mund ta krijojë ose ta shkatërrojë një kompani. Rritja e produktivitetit në punë është e një rëndësie supreme në botën e sotme konkurruese. Në terma të thjeshtë, produktiviteti definohet nga ajo se sa mund të prodhohet në një periudhë të caktuar kohore. Për të rritur produktivitetin, duhet të rritet sasia e prodhimit ose të zvogëlohet koha që duhet për të prodhuar sasinë e njëjtë, apo kombinimi i të dyjave bashkë.

Ky studim është kryer për t'i shqyrtuar faktorët të cilët ndikojnë në produktivitetin në punë, ku si rast studimi janë marrë kompanitë e mëdha në Ferizaj. Objektivat e këtij studimi janë: i) identifikimi i ndikimit të stresit në produktivitetin në punë; ii) identifikimi i ndikimit të pagës në produktivitetin në punë; iii) identifikimi i i ndikimit të ambientit të punës në produktivitetin në punë dhe iv) identifikimi i ndikimit në produktivitet nga mbingarkesa në punë. Për këtë studim është përdorur pyetësor si formë e grumbullimit të të dhënave. Të dhënat përbëhen nga një mostër reprezentative prej 50 punëtorëve nga institucionet e përzgjedhura. Analiza e të dhënave tregon se të gjithë këta faktorë ndikojnë në produktivitet mirëpo më dominantët janë stresi dhe ambienti i punës, në një krahasim të përgjithshëm.

Fjalë kyç: *produktivitet, punë, stres, pagë, ambient në punë, mbingarkesë.*

RËNDËSIA E PANAIREVE NË PROMOVIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESEVE NË SHQIPËRI

Prof. As. Dr. Ervin Myftaraj

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

e-mail: ervin.myftaraj@yahoo.com

Msc. Artenisa Myftaraj

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: artenis01@hotmail.com

Abstrakt

Ky punim trajton çështjen mbi zhvillimin historik të panairove në Shqipëri, llojshmërinë e tyre, intensitetin si dhe rëndësinë që kanë për tregun shqiptar. Gjithashtu, në këtë punim përfshihen disa tematika që janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimet e mëtejshme të panairove si: llojet e tyre në Shqipëri, pjesëmarrja në panairove ndërkombëtare si dhe rëndësia që kanë ato për bizneset shqiptare.

Panairi është një fenomen dhe veprim ekonomik që mund t’u shërbejë palëve të ndryshme me interesa të ndryshme nëpërmjet takimit apo mbledhjes në një vend. Një panair organizohet nga mbështetja dhe nxitja e organizmave të ndryshme p.sh. “nxitja nga qeveria”, “nxitja nga tregu”, “nxitja nga shoqëria”, “nxitja nga qeveria dhe tregu”.

Panairi është vendi ku nëpërmjet mbledhjeve dhe ekspozitave takohen tregtar, mallra, intelektualë, fonde dhe shkëmbehen informacione duke nxitur drejtpërdrejtë zhvillimin e tregtisë, turizmit etj. dhe duke tërhequr investime për të nxitur zhvillimin e industrive të tjera. Në thelb, panairi është i përbërë nga mbledhja dhe ekspozita. Shumica e mbledhjeve janë ato ndërkombëtare, ku zhvillohen edhe simpoziume të ndryshme.

Për realizimin e këtij punimi është përdorur literatura e marketingut, të dhënat dytësore dhe përzgjedhja e 47 bizneseve. Metoda më e famshme e pyetjeve të vlerësimit është metoda Shkalla e 5-Likert. Në këtë pyetësor janë ndërthurur 19 pyetje, të cilat përfaqësojnë bazën teorike të studimit. Të dhënat janë analizuar nëpërmjet dy programeve

kompjuterike SPSS dhe Statgrafics, duke përdorur metoda të ndryshme statistikore.

Përfundimet e këtij kërkimi sugjerojnë se variablat e marra në studim kanë shumë rëndësi në promovimin e bizneseve nëpërmjet panairëve.

Fjalë kyç: *panair, marketing , promocion, komunikim.*

ZHVILLIMI EKONOMIK I KOSOVËS DHE INTEGRIMI I SAJ NË BE, KOMPLEKSITETI I PROCESIT DHE SFIDAT KRYESORE

PhD Fadil OSMANI

Kolegji AAB

E-mail: fadil.osmani@gmail.com

Abstrakt

Funksionimi i sistemit të sundimit të ligjit, është më se i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe integrimin e saj në Bashkimin Evropian. Ndonëse, ekziston një përkushtim verbal nga autoritetet e Kosovës për forcimin e sundimit të ligjit, problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova në këtë fushë janë komplekse dhe të shumta, ndërsa duhet të investohet në shumë burime për të arritur deri te përmirësimet e nevojshme.

Kosova si shtet i ri i cili pretendon të hyjë në Bashkimin Evropian, ballafaqohet përafërsisht me probleme të njëjta si të gjithë fqinjët e saj, por në anën tjetër në masë të madhe ballafaqohet me problemin politik, posaçërisht në raport me Serbinë, ku kjo e fundit refuzon të pranojë de jure shtetësinë e Kosovës. Por, marrëveshjet e arritura në Bruksel, të cilat rregullojnë normalizimin e raporteve në mes Beogradit dhe Prishtinës, janë sinjal i parë në drejtim të krijimit të një stabiliteti politik për Kosovën. Sidoqoftë, marrëveshjet duhet të realizohen në praktikë në mes të dy palëve, realizimi i tyre mbetet një sfidë konkrete, ndërsa vazhdimi i dialogut mbetet në perspektivën e ndërtimit të fqinjësisë së mirë në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe njohjes “de jure” reciproke mes dy shteteve.

Fjalë kyç: *integrim, Kosovë, Bashkim Evropian, zhvillim ekonomik, sfidë.*

ECONOMIC SUSTAINABILITY AS REGIONAL DEVELOPMENT FACTOR

Fidan Qerimi, PhD C,

Kolegji AAB – Prishtinë, Kosovë
Email: fidan.qerimi@aab-edu.net

Muhamet Hajdari, PhD C,

Kolegji ISPE
Email: muhamet.hajdari@gmail.com

Jusuf Fejza, Prof. i Assoc. Dr,

Kolegji AAB
Email: jusuf.fejza@aab-eu.net

Abstract

Globalisation, with such rapid involvement and proliferation led to changes in regional developments, creating divisions in various forms of businesses. Negligence in global market competition caused disturbances in the supply of goods as well as in economic services. This phenomenon exceeded humanity's needs for development and excessive prosperity, neglecting the care of future generations.

Sustainability should cover all human life needs as well as global developments in both individual and social aspects. This requirement requires harmonisation of global needs and demands of the population by taking care of natural resources and assets through limited investments in compliance with the implementation of laws and technical-technological developments.

Harmonisation between the needs for spending and unlimited personal demands it requires individual engagement to establish a balance of opportunities and feasible investments in global businesses.

Keywords: *Sustainability, business, region, development*

SFIDAT, PROBLEMET DHE PËRFITIMET E BIZNESIT TË VOGËL NGA INOVACIONET: HULUMTIM EMPIRIK NGA KOSOVA

**Fitim HOXHA,
Roberta BAJRAMI, PhD**

fitim.hoxha@hotmail.com, roberta.bajrami@aab-edu.net

Abstrakt

Në këtë punim do të diskutohet për sfidat, problemet dhe përfitimet e ndërmarrjeve të vogla nga inovacionet. Nga hulumtimet rreth vizionit për zhvillimin ekonomik për të ardhmen në Kosovë, zhvillimi ekonomik është i fokusuar rreth mundësive inovative për çdo sektor, inovacione në teknologji, ofrimin e produkteve të reja, thënë me një fjalë krijimin e një dukurie të re që mundëson në zhvillimin e bizneseve. Për këtë arsye ky punim së pari do të shqyrtojë se sa janë të informuara bizneset e vogla për inovacionet dhe mundësitë që sjellin ato? Së dyti në këtë punim do të diskutohet për inovacionet që ndërmarrjet e vogla kanë përdorur dhe për ndikimin e tyre në zhvillimin e bizneseve dhe së fundmi për problemet dhe vështirësitë që ndërmarrjet e vogla kanë hasur rreth aplikimit të inovacioneve. Metodologjia e përdorur në këtë punim do të jetë me metodën empirike nga e cilado analizohen të dhënat primare të marra nga 100 biznese të vogla në Kosovë. Analizimi i rezultateve do të bëhet me anë të programit SPSS dhe do vërtetohet se në bizneset e vogla në Kosovë nuk aplikohen mjaftueshëm inovacionet dhe si rezultat i kësaj edhe bizneset kanë zhvillim të vogël.

Fjalë kyç: *inovacion, biznese të vogla, mundësi, sfidë.*

ROLI I FMN-së DHE I BB-së NË MBËSHTETJEN E REFORMAVE NË SEKTORIN PUBLIK NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Prof. ass. dr. Florije Miftari

Kolegji AAB

E-mail: florije.miftari@aab-edu.net

Mirko Tripunoski,

E-mail: mirko.tripunoski@fon.edu.mk

Maja Tripunoska

Abstrakt

Fondi Monetar Ndërkombëtar edhe pse fokus kryesor ka mbështetjen financiare dhe teknike në sferën monetare dhe atë të bilancit tregtar dhe pagues për vendet anëtare, po ashtu ka ofruar prej kohësh këshilla dhe asistencë teknike për të nxitur qeverisjen e mirë, të tilla si promovimin e transparencës të sektorit publik dhe llogaridhënien etj. Po ashtu edhe Banka Botërore duke shfrytëzuar instrumentet e kreditimit, ndihmon dhe mbështet vendet anëtare në nevojë për të realizuar reforma publike. Marrë parasysh faktin se vendet e Ballkanit Perëndimor, në vitet e 90-ta filluan reformat e tranzicionit nga sistemet shumëpartiake në ato pluraliste, roli i institucioneve financiare ndërkombëtare ka qenë i rëndësishëm në fushën e reformave strukturore të këtyre shteteve.

Qëllimi i punimi është që, duke përdorur metodën e analizës dhe atë komparative, të shqyrtojë dhe analizojë instrumentet e kreditimit dhe të mbështetjes financiare të Bankës Botërore, të dedikuara për reformat në sektorin publik në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri, në periudhën prej anëtarësimit në këto institucione deri në vitin 2016. Hulumtimi fokusohet në kreditimin dhe asistencën teknike të ofruar nga këto institucioneve në sferën e menaxhimit financiar, menaxhimit të ardhurave, transparencës, shërbimeve administrative dhe civile dhe në përforcimin e kapaciteteve institucionale.

Fjalë kyç: *FMN, Bankë Botërore, kreditim, sektor publik, asistencë teknike.*

LEGAL INFRASTRUCTURE IMPACT ON BUSINESS ENVIRONMENT IN WESTERN BALKAN REGION

Doc. Gelina Maliqi
AAB College University
Email: gelinamaliqi@gmail.com

Abstract

For more than a decade, all the Western Balkan countries are in a struggle to face the challenges they fall over during their path of integration. The tendency to increase the economy has been the cornerstone of our country's governing policies. Dealing with international markets and exchanges has also been and still is part of the challenges where embracing common standards and rules of inter-business cooperation, the need for legal equivalence in all countries of our region has become inevitable. Gone by these requirements, we note that the legislation of each country has drafted the legal package under the European Union Directives, which greatly facilitate the procedures of trade, customs, regional and international circulation. Precisely, this legal evolution that best supports the business environment, I will analyze in my scientific paper regarding this conference.

By dividing the stages of development and the areas under which business is being supported and developed, this paper will address the legal evolution that has already created its status in front of the European Union member states and beyond. As more as harmonized will be the legal framework, more solid and sustainable it becomes the business development environment in our region. This role of legal infrastructure also becomes tangible in the implementation of bilateral, regional and multilateral business agreements.

Keywords: *Legal infrastructure, business environment, integration, economic development, legal harmonization.*

THE ROLE OF RISK CAPITAL AND CAPITAL FUNDS RISKS IN SUPPORT OF THE DEVELOPMENT OF SMALL AND AVERAGE ENTERPRISES

Prof. Asoc. Dr. Gëzim Selimi

AAB College, Prishtinë

Email: gezimselimi@gmail.com

Abstract

The focus of this paper, primarily, is the current global enterprises problem to finance their business ideas. Through this analysis will try to explain the need to use capital risk fund in order to support or stimulate a business. The use of this alternative source of financing is particularly important when bank loans are expensive or lack of scholarship as a source of capital for financing enterprises.

In the Republic of Macedonia and in the countries around us, we constantly hear that one of the most significant problems is financing enterprises. Indeed, this is true, especially if we take into consideration that there are no sufficient "alternative funding sources". Without having a developed network of sources of funding, business owners and managers of small businesses need a very long time to solve the problem of financing their business.

Key words: *funds, capital risk, business angels, global enterprises.*

TURIZMI I QËNDRUSHËM SI FAKTOR I ZHVILLIMIT EKONOMIK NË KOSOVË

Gëzim Shabani, PhD Cand.

Kolegji AAB, Prishtinë,
Email: gëzim.shabani@aab-edu.net

Prof. asc. dr. Jusuf Fejza,

Kolegji AAB, Prishtinë,
Email: jusuf.fejza@aab-edu.net

Abstrakt

Qëndrushmëria në një lëmi biznesore bazohet në pasuritë natyrore në atë vend, duke ndikuar në cilësinë e shfrytëzimit. Pasuritë natyrore lidhen ngushtë edhe me pozitën gjeografike të atij vendi, si potencial për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Lëmia e turizmit është ndërlidhur me zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të një vendi e në veçanti të rajonit. Pasuritë natyrore e begatojnë cilësinë e zhvillimit të turizmit dhe ndikimit të tij në ekonominë e qëndrueshme të atij vendi. Faktorët që ndikojnë në përhapjen e turizmit dhe zhvillimin ekonomik janë të natyrës sociale dhe të zhvillimi individual të popullatës. Punimi trajton identifikimin e kapaciteteve dhe resurseve kryesore të qëndrueshme turistike të Kosovës dhe harmonizimi i planeve strategjike vendase me ato rajonale e ndërkombëtare. Ky harmonizim njëherësh paraqet garanci për ngritjen e cilësisë së turizmit në përgjithësi, si rezultat i rritjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve turistikë brenda vendit dhe në konkurrencën rajonale.

Fjalë kyç: *turizëm, qëndrueshmëri, zhvillim, ekonomi.*

SOCIAL INCLUSION THROUGH MICROFINANCE PROGRAMS

Gilda Hoxha, PhD Cand.

University of Tirana,

Email: gildahoxha@gmail.com

Forcim Kola, PhD

“Marin Barleti” University, Tirana

Email: forcinkola@gmail.com

Abstract

The aim of this research analysis is to investigate on the Albanian society regarding *the social inclusion* through *microfinance industry*. In a context marked by the goal of microfinance, the principal aims are to examine how microfinance programs are involved in a developing country and their influence on social inclusion. The relationship between the concept of “*microfinance*” and “*social inclusion*” in Albania will be viewed from a perspective based on the national, political and social contexts that conditioned the microfinance goals and strategies. The features of Albanian microfinance industry are also treated in this paper, followed by focusing on the debate: “*Has the microfinance industry helped the development and social inclusion in Albania?*”. Analyzing microfinance industry in Albania, one can easily note that the way the microfinance industry works, acts and cooperates with different factors as financial, human and technical, trying to convert an important element for *social* and *economical development*. For analytical purposes, the discussion is organized in two main parts; The first part, examines theoretical part focusing on key issues that relate *government, civil society, microfinance program* and its role to the *social inclusion*. The second part examines Albanian Microfinance industry and its product during ‘*transition*’ in reference to the first normative part.

Keywords: *Microfinance Industry, Social Incusion, Impact, Albania*

SIGURIA NË EKONOMI SI GARANTUESE E INTEGRIMIT DHE MIRËQENIES

PhD. Hekuran RAPAJ

Universitetin “Iliria”

E-mail: hekuranalirapaj@live.com

Abstrakt

Siguria është një çështje e politikave të larta, ndaj ajo ngelet qendrore për debatet qeveritare, akademike dhe mediatike, e rëndësishme për prioritetet e përcaktuara prej tyre. Tradicionalisht, objekti që duhej siguruar ka qenë shteti, i cili në shkencat politike, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të sigurisë, njihet si objekt referues. Ndërsa aktualisht, shkencat e sigurisë gjejnë edhe qasje alternative ndaj sigurisë, të cilat ofrojnë objekte të ndryshme referuese, mjete të ndryshme për arritjen e sigurisë. Studimi i një sektori që në pamjen e parë duket më pak problematik, në lidhjen e tij me sigurinë është ekonomia. Ajo që duhet siguruar, nuk është thjesht ekonomia, por aftësia për të qenë e qetë në misionin e saj për prosperitetin aktual dhe për të ardhmen.

Në pjesën më të madhe të literaturës dhe studimeve të bëra në këtë fushë, përqendrimi është fokusuar te siguria ekonomike “makro-nivelore”, ndërsa ne do të përqendrohemi te siguria ekonomike “mikro-nivelore”. Në terma të përgjithshëm, do të thotë që siguria ekonomike “mikro-nivelore” përqendrohet në aktorë të “lokalizuar”. Studimi do të tregojë nevojën e domosdoshme të masave shtetërore për vijueshmëri të qetë në investimet ekonomike në tregun shqiptar, garantimin shtetëror për sigurinë dhe shqetësimet e përcjella në këtë drejtim përballë realitetit, në funksion të rritjes ekonomike e sociale të individëve, familjeve dhe shoqërisë.

Fjalë kyç: *siguri, integrim, ekonomi, mirëqenie.*

ECONOMIC GROWTH AND FEMALE LABOUR FORCE PARTICIPATION IN BALKAN COUNTRIES

Msc. Jonida Gashi

“Aleksandër Moisiu” University, Durrës,
E-mail: g.jonida@hotmail.com

Msc. Erinda Guma

Regional Tax Directory, Durrës,
E-mail: indaguma@gmail.com

Abstract

This paper investigates the relationship between female labor force participation rates and economic growth in Balkan countries. It was hypothesized a U-shaped relationship between these variables. The shape of this curve represents the idea that as incomes rise, the female labor force participation rates initially decreases to a certain point and then begins to increase. To examine these relationships, data on female labor force participation and per capita income are extracted from the World Development Indicators 2017 database. The relationship is examined by using a panel data analysis for the period 1997 - 2015. The findings of these articles are especially important to help design policies to improve women’s labor force participation rate for Balkan countries.

Key words: *Economic growth, female labor force, U-shaped curve, Balkan countries, panel data.*

KORRELACIONI I TË HYRAVE DHE NUMRIT TË PUNËTORËVE NË RRJETIN SOCIAL FACEBOOK

Dr. Jusuf Qarkaxhija
Kolegji AAB
jusuf.qarkaxhija@aab-edu.net

Abstrakt

Një ndër faktorët kryesorë përmes të cilëve e vlerësojmë performancën e një organizate biznesi është edhe rritja e numrit të punëtorëve. Ky është një faktor përcaktues që duhet të tregojë se punët në organizatë shkojnë mbarë. Mirëpo, që rritja e numrit të punëtorëve të jetë e qëndrueshme atëherë kjo duhet të bëhet proporcionalisht me rritjen e të hyrave në organizatë dhe zhvillimin e saj. Statistika është shkencë e numrave e cila na mundëson që të gjejmë një relacion dhe marrëdhënie në mes të këtyre dy dukurive. Si funksion statistikor përmes të cilit gjejmë fortësinë e lidhjes ndërmjet dy dukurive, do të thotë pra në mes të rritjes së numrit të punëtorëve dhe rritjes së të hyrave është faktori i korrelacionit. Kompania për të cilën do të gjejmë lidhjen në mes këtyre dy dukurive është “Facebook.Inc”. Analizimi i korrelacionit dhe studimi i tij do të shtrihet në kohë në një periudhë trevjeçare, më saktësisht në tri vitet e fundit 2014, 2015 dhe 2016. Si rast studimi treguam se është marrë kompania “Facebook.Inc”, sepse jemi nisur nga supozimi se kompania në fjalë është shumë serioze, pasi ka afër dy miliardë shfrytëzues të shërbimeve të saj dhe nga kur ekziston, nga viti 2004 ka pasur rritje shumë të madhe të numrit të punëtorëve dhe të hyrave. Nga studimi presim që të vërtetojmë se raporti i fortësisë ndërmjet këtyre dukurive do të jetë gati perfekt, pra, duhet ta ketë vlerën prej 0.8 deri te ajo maksimale 1, ose do t’i afrohet këtij brezi. Sa më poshtë vlerës 1 atëherë fortësia e lidhjes do të dobësohet. Gjetjet nga ky studim janë shumë të rëndësishme pasi në bazë të trendit të të hyrave mund të bëjmë parashikimin e investimeve në të ardhmen.

Fjalë kyç: *korrelacion, punëtor, fitim, facebook, fortësi, trend etj..*

PËRDORIMI I FACEBOOK SI PLATFORMË REKLAME ONLINE, RASTI I “MONETA-MONEY GRAM”

Kaltrina Vladi

Kolegji AAB, Prishtine

Email: kaltrina.vladi@aab-edu.net

Naim Neziri

Kolegji AAB, Prishtine

Email: naim.neziri@aab-edu.net

Abstrakt

Reklammat në internet mund të çojnë në rritjen e të ardhurave, të numrit të konsumatorëve dhe të përhapjes së emrit të kompanisë. Jo vetëm kaq, por ato janë një kanal marketimi me kosto më të ulët që bizneset e vogla mund ta shfrytëzojnë për të depërtuar direkt te konsumatorët. Një nga kanalet e reklamimit online që po njihet përdorim tejet të madh këto vitet e fundit në botë, është rrjeti social Facebook.

Facebook, gjen përdorim të gjërë edhe në Kosovë, por jo në nivele profesionale që të japë rezultate të pritshme. Pikërisht këtu qëndron rëndësia e punimit që synon t'i vetëdijesojë kompanitë kosovare që t'i kushtojnë rëndësi më të madhe përdorimit dhe strategjive të marketingut në Facebook.

Nga të dhënat e grumbulluara është hedhur poshtë hipoteza e ngritur në këtë punim se facebook është rrjet social i të rinjve. Të dhënat dëshmojnë se facebook prin si aktiviteti kryesor online jo vetëm e të rinjve dhe kjo e bën një kanal të rëndësishëm për marketing. Duke parë këtë rëndësi, punimi fokusohet dhe analizohen strategji adekuate për reklamimin e kompanive, me theks të veçantë të kompanisë Moneta – MoneyGram.

Fjalë kyç: *reklamë, facebook, strategji marketingu, Moneta – MoneyGram.*

NDIKIMI I SEKTORIT PRIVAT NË RRRITJEN E QËNDRUESHMËRISË EKONOMIKE NË KOSOVË

Kosovare Ukshini, PhD Cand.

Kolegji AAB

E-mail: kosovare.ukshini@aab-edu.net

Abstrakt

Kosova edhe pas luftës vuan nga gjendja e rëndë ekonomike e cila është e karakterizuar me normë të lartë të papunësisë. Pavarësisht faktit që kemi një fuqi punëtore të re dhe të mirëkualifikuar, ky fakt nuk po ndikon që të kemi një treg të punës të fuqishëm dhe të mjaftueshëm për të absorbuar gjithë ofertën e punës ekzistuese dhe potenciale që është në treg. Kjo situatë ka krijuar pasiguri ekonomike, prandaj sektori privat nuk është duke luajtur rolin e zhvilluesit dhe stabilizuesit ekonomik në Kosovë ashtu siç duhet ta ketë.

Njëri nga sektorët i cili konsiderohet si bartës i zhvillimit ekonomik në Kosovë, është ai privat, i cili është përbërë në përqindje të lartë nga NVM-të të cilat llogariten si prodhuese të vendeve të reja të punës, si dhe të produkteve dhe shërbimeve të reja. Nga njëra anë ato janë krijuese më të mëdha të vendeve të reja të punës, por nga ana tjetër janë të karakterizuar me nivel të lartë të paqëndrueshmërisë.

Pyetjet kërkimore që këtu shtrohen janë se cila është gjendja e sektorit privat në Kosovë dhe cili është ndikimi i tyre në shtimin e vendeve të punës, janë çështje që gjejnë shpjegim në këtë punim.

Pavarësisht këtyre fakteve, NVM-të konsiderohet si shkaktare kryesore të shtimit të vendeve të reja të punës, por është shumë me rëndësi nëse këto vende pune janë duke shtuar vlerën e cila shpie në rriten ekonomike.

Fjalë kyç: *sektor privat, NVM, punësim, rritje ekonomike, Kosovë.*

NDIKIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE NË MJEDISIN BIZNESOR

MA. Kreshnik Kaçiu
University of Maastricht
E-mail: kreshnik.kaciu@gmail.com

Abstrakt

Përmes këtij punimi synojmë që të trajtojmë çështjen e ndikimit të infrastrukturës ligjore në mjedisin biznesor. Ky punim do t'i analizojë masat ligjore që janë ndërmarrë për sigurimin e një mjedisi të sigurt biznesor, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në infrastrukturën ligjore që promovon Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera shtetërore, duke përfshirë edhe Parlamentin si dhe institucionet tjera joshetërore që merren me lobimin për përmirësimin e infrastrukturës ligjore me qëllim të përmirësimit të mjedisit biznesor. Në këtë kuptim do të definohen rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe lokale në secilën fazë të procesit të hartimit dhe zbatimit të legjislacionit në fushën e të bërit biznes. Problematikat e tilla kërkojnë një trajtim tepër specifik, duke u fokusuar në metoda analitike dhe krahasimtare, pasi fenomeni i kritikave rreth mungesës apo jo të infrastrukturës ligjore në mjedisin biznesor, është temë aktuale në Kosovë që nga paslufta e deri më tani. Prandaj, risia që sjell ky punim është roli dhe rëndësia që ka krijimi i infrastrukturës ligjore të qëndrueshme dhe kompatible me legjislacionin e BE-së, i cili do të mundësonte një mjedis biznesor më të mirë në Kosovë.

Fjalë kyç: *infrastrukturë ligjore, mjedis biznesor, institucione, masa ligjore.*

STUDIM I PERCEPTIMEVE TË KONSUMATORIT SHQIPTAR PËR PËRPARËSITË E BLERJEVE ONLINE

Jonida Rrumbullaku

Menaxhere e marketingut, Max-Optika, Tiranë

E-mail: j.rrumbullaku@maxoptika.al

Kristaq Kume

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: kkume09@gmail.com

Abstrakt

Për të vlerësuar perceptimet e konsumatorit shqiptar për përparësitë që ka blerja online u përdorën të dhënat e përgjigjeve të 217 konsumatorëve, të cilët, gjatë muajit të fundit kishin bërë të paktën një blerje online. Ndër ta 62% ishin femra. Struktura e moshës se tyre ishte 42 % - 18-25 vjeç, 35 % - 26-36 vjeç dhe 23% ishin te moshës mbi 37 vjeç. Rreth 11% kishin blerë online 1-2 herë, 47%, 3-5 herë, 18%, 6-8 herë dhe 24% kishin blerë *online* më shumë se sa 8 herë. Analiza faktoriale eksploruese tregoi se perceptimet e konsumatorit për përparësitë e blerjeve online ndikohen nga faktorët: (i) komoditet në blerje (25.6%), (ii) mundësi e madhe për zgjedhje të produktit (21.4%), (iii) lehtësi në blerje (16.7%) dhe (iv) kënaqësi (10.6%). Së bashku këta faktorë arrijnë të shpjegojnë rreth 74.3% të variancës së përgjithshme të perceptimeve. Faktorët përgjegjës për formimin e perceptimeve për përparësitë e blerjeve online ndërlidhen pozitivisht me perceptimin e internetit si medium për blerje, frekuencën e vizitave në internet, frekuencën e blerjeve online dhe kohën që shpenzohet për blerje online.

Duke qenë se madhësia e kampionit është e vogël dhe se tregu virtual në Shqipëri karakterizohet nga një dinamikë e madhe ndryshimi, rezultatet e studimit duhet të pranohen si rezultate paraprake që japin informacion për të kuptuar sjelljen e konsumatorit shqiptar në tregun virtual.

Fjalë kyç: *blerje online, përparësi, perceptim, konsumator.*

PRIORITETET QEVERISËSE PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

Medain Hashani PhD

Kolegji AAB

E-mail: medain.hashani@aab-edu.net

Abstrakt

Ky punim diskuton identifikimin e problemeve për një zhvillim jo të qëndrueshëm ekonomik që ka aktualisht Kosova dhe nevojën e ndërtimit të prioriteteve qeverisëse nga lidershpi politik për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë. Hulumtimet në këtë fushë kanë treguar se në politikave ekonomike të Kosovës, të aplikuara që nga paslufta nga lidershpi politik iu mungojnë prioritetet të cilat duhen t'i kenë si bazë për zhvillimin ekonomik. Metodologjia e përdorur në këtë studim është nëpërmjet metodës empirike. Analiza e të dhënave të përfituara në këtë studim dëshmoi se në rastet kur nuk përcaktohen prioritetet nga lidershpi politik, të gjitha vendimet merren ad hoc dhe pastaj paraqiten probleme me zhvillimin ekonomik. Të dhënat empirike vërtetuan se identifikimi i problemeve në mënyrë të drejtë të orienton se cilat prioritete duhet të ndërtohen për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Gjetjet nga ky studim kanë rëndësi të veçantë për Qeverinë e Kosovës dhe tërë liderët e partive politike në Kosovë.

Fjalë kyç: *prioritetet qeverisëse, zhvillimi ekonomik, lidershpi politik, politikë ekonomike, Qeveri e Kosovës.*

THE MARKETING MANAGEMENT DESIGN OF THE ORGANIZATIONAL DEMAND IN PROMOTING COMPETITIVENESS AND PROSPERITY OF DECOMPOSITION

PhD. Mirko Tripunoski

University FON, Skopje

Email: mirko.tripunoski@fon.edu.mk

Maja Tripunoska,

Economist, Skopje

Email: mtripunoska@yahoo.com

PhD.Neritan Turkeshi

Email: neritan.turkeshi@fon.edu.mk

Abstract

The authors of this paper analyzed the marketing management and design of the organizational demand for improving the competitiveness and prosperity of decomposition from two aspects. First, what is the highest possible level of demand for all products in which a certain amount of time is achieved? The answer can be found looking at the potential of the market intended for that product, the impact of design and marketing conditions in the external environment. Second, what level of sales can be expected, as a real indicator and its realization, with special consideration which will have external factors and efforts in achieving marketing design. The authors of this paper will give details and explain the answer to this question, through assessment in improving the competitiveness and economic assessment of subjects for future sales. However, such an analysis and assessment of competitiveness will be processed through an open partnership which will indicate how sustainable development is achieved, which is the level of marketing efforts and the investment firms in future sales.

The authors determined the intermediaries indicators and drivers of organizational demand through competitive environment, where exports are seen as a diagnostic tool and a driver, and as a future dimension of competitiveness, putting emphasis\r\non domestic innovation, exports, imports, domestic investment, where productivity depends on three factors: the inherited wealth; the macroeconomic competitiveness and the microeconomic capability of business entities.

Keywords: *organizational demand, competitiveness, indicators, factors, sale*

KANALET E DISTRIBUIMIT NË TREGUN E SIGURIMEVE NË KOSOVË

Muhamet Hajdari, PhD Cand.

Kolegji ISPE

E-mail: muhamet.hajdari@gmail.com

Fidan Qerimi, PhD Cand.

Kolegji AAB

E-mail: fidan.qerimi@aab-edu.net

Abstrakt

Në Kosovë veprojnë 13 kompani të sigurimeve, të cilat kryesisht janë kapital i huaj. Mënyra e shpërndarjes së sigurimeve në Kosovë bëhet nga agjentët që në literaturë njihen si agjentë të varur. Gjithashtu tregu i sigurimeve është i zhvilluar kryesisht në sigurime të detyrueshme që në Kosovë janë të përcaktuara me ligj. Tema që ne trajtojmë specifikon llojin e shpërndarjes së sigurimeve që aktualisht ofrojnë kompanitë e sigurimeve, impaktin negativ dhe pozitiv që del nga kjo mënyre e distribuimi, pengesat që ato paraqesin në zhvillimin e tregut, e posaçërisht në produktet vullnetare të sigurimeve. Pas paraqitjes aktuale të kanaleve të distribuimit të sigurimeve në Kosovë ne kemi bërë edhe krahasimin e kanaleve të shpërndarjes së sigurimeve në shtetet e zhvilluara dhe në shtetet e rajonit. Kemi paraqitur disa statistika të cilat tregojnë për shpërndarjen e produkteve të sigurimeve, për sigurime jete dhe të tjera, e gjithashtu do të shohim se sa është i zhvilluar tregu i sigurimeve në këto shtete. Nëpërmjet këtij punimi ne kemi nxjerrë disa konkludime të cilat konsiderojmë se duhet të aplikohen në tregun e sigurimeve në Kosovë. Rekomandimi bazohet në metodat e shpërndarjes së sigurimeve në shtetet e zhvilluara, pastaj në përparësitë që japin këto metoda apo mënyra të shpërndarjes së sigurimeve.

Fjalë kyç: *sigurim, kanal, distribuim, Kosovë.*

INVESTIMET NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR DHE NDIKIMI I TYRE NE ZHVILLIM EKONOMIK

PhD. Naim Ismajli

Kolegji AAB

E-mail:naimismajli@yahoo.com

Abstrakt

Që nga paslufta Kosova ballafaqohet me dy sfida shumë të rëndësishme për ndërtimin e qëndrueshëm të shtetit. Këto sfida janë arsimit dhe zhvillimi ekonomik të cilat janë shtyllat kryesore për një stabilitet në vend. Deri më tani janë hartuar shumë plane strategjike për zhvillimin e arsimit parauniversitar, të cilave iu mungon analizimi i dukurive kyçe e që është nxjerrja e kuadrove të reja për tregun e punës. Për këtë arsye në këtë punim do të diskutohen dhe analizohen faktorët edukativë - arsimorë të cilët kanë impakt në stabilitetin ekonomik. Me anë të këtij hulumtimi do të shqyrtohet raporti në mes të buxhetit të shtetit dhe investimet kapitale ne AP 1, investimet në kurrikula dhe pilot-projekte, investime në staf (kurse, trajnime). Pas analizimit të këtyre dukurive do të matet ndikimi i variablave në fjalë në uljen e papunësisë e cila ka impakt në GDP-në e vendit. Këto variabla do të analizohen për periudhën kohore 2008 deri 2016 dhe në bazë të këtyre do bëhen parashikimet për të ardhmen. Të dhënat empirike do vërtetohen me anë të modelit OLS. Nga ky punim do të dalin rekomandime për prioritetet në investime në arsimin parauniversitar të cilat do të ndikojnë në rritje të qëndrueshme ekonomike.

Fjalë kyçe: *arsim parauniversitar, zhvillim ekonomik, model OLS, investime në AP.*

ATTRACTING FDI TREND IN THE SERVICES SECTOR FROM THE HIGH INTEREST RATES AND INTERACTION WITH THE HUMAN CAPITAL IN KOSOVO

Dr. sc. Nakije Kida

AAB College

Email: nakijekida@gmail.com

Abstract

The purpose of the paper is to evaluate whether the interest rates (IR) and human capital (HC) have effect in attracting the flows Foreign Direct Investment (FDI) in the services sector over the years 2007-2016. The OLS approach is used to examine the effect of variables, while the Pearson test is used to validate the correlation between these variables. The most interesting finding is the positive sign of interaction between FDI and human capital (IHD*HC), which means that cheap, dynamic, young and adequately educated workforce meets the requirements of foreign firms for skilled workers. Increase of FDI inflows in the services sector in Kosovo, especially in the banking one, can also be attributed to high interest rates. The result of the Pearson test revealed the existence of positive correlations of interest rates and human capital with the FDI in the services sector, deriving from the inappropriate economic policies offered by Kosovo. Implications Government should reduce the dependency level of business access as the only source of finance in foreign banks in Kosovo. The increase in number of the local banks increases the possibility of reducing the "crowding-out" effect of the services sector as a consequence of repatriation of their capital in the home country. The government can achieve this strategy by playing a more active role in expanding the credits with lower rates, an opportunity of productive investment increase in other sectors of the economy and encouragement of the quality in the secondary and higher education as a necessity.

Key words: *FDI, services sector, interest rates, human capital, Republic of Kosovo.*

SFIDAT DHE MISIONI I LIDERSHSHIPIT TË DISA VENDEVE BALLKANIKE DREJT INTEGRIMEVE EKONOMIKE EVROPIANE

Prof. ass. Dr. Nazmi Iballi
Kolegji AAB,
E-mail: nazmi.iballi@aab-edu.net

Abstrakt

Sfidat e vendeve ballkanike duhet shikuar specifikisht në dy rrafshe të dallueshme nga njëra-tjetra, qoftë për karakteristikat që kanë ndërmjet vete në njërin anë, si dhe specifikisht në raportet e secilit vend me Bashkimin Evropian. Si të tilla, vendet ballkanike pas viteve të 90-ta u përballën me shpërbërje dhe destrukurim shumëdimensional (normalisht i komponuar jonatyrshëm) ideologjik-ekonomik e territorial, drejt një ristrukturimi krejtësisht tjetër me një pluralizëm heterogjen më racional, që në esencë të do të ketë ekonominë e tregut dhe pluralizmin politik. Këtë pretendim për rivendosje faktorësh drejt krijimit të „rendit të ri” në Ballkan, përkundër rolit fascilitues të BE-së por të pa standardizuar njëtrajtshëm, lidershipi ende nuk po mund ta akceptojë për mungesë vizioni si domosdoshmëri për ndryshim strukturor. Për këto fakte si më lart, klasa politike e vendeve ballkanike domosdoshëm duhet të përballet me kriteret dhe kushtet e kërkesës konstante nga BE-ja për një transformim për integritime. Këto kriteret, siç janë: kushtet e një tregu të lirë, pluralizmi politik me zgjedhjet e lira, gjyqësori i pavarur, reforma në ekonomi dhe stabiliteti makroekonomik, kërkesat që dalin nga Asqua Communitare, MSA-ja, statusi i Vendit Kandidat, Marrëveshjet me FMN-në dhe BB-në, gjithsesi paraqesin sfidat kyçe për të cilat kërkohet gatishmëria e përballjes dhe ndryshimit shumëdimensional të qasjes dhe veprimit aktiv të lidershshit.

Fjalë kyç: *integritime evropiane, Marrëveshje e Stabilizim Asociimit, Asqua Communitare, Komisioni Evropian, FMN.*

NDIKIMI I INOVACIONEVE NË RITJEN E EFIKASITETIT TË FIRMAVE DHE TEJKALIMIN E SFIDAVE GLOBALE

Dr.Sc. Pleurat Mustafa

Kolegji AAB

E-mail: pleuratmustafa@hotmail.com

Prof. Asoc. Dr. Julejda Gërxhi

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: julejda@gmail.com

Abstrakt

Inovacioni është kusht për çdo lloj biznesi, në mënyrë që ai të qëndrojë në treg e të ketë sukses të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm. Shpeshherë, pronarët apo menaxherët e bizneseve habiten pse shitjet bien apo pse biznesi shkon gradualisht drejt falimentimit. Përgjigjja në të shumtën e rasteve është mungesa e inovacionit. *Peter Drucker* në publikimin e *Harvard Business Review* (1995) shkruan se: “Inovacioni është një kompetencë e nevojshme për të ardhmen, së bashku me aftësinë për të matur performancën e tij”. Firmat më të vogla duken të kenë përparësi në industritë në zhvillim me nivel të lartë të inovacionit. Firmat më të vogla gjithashtu kontribuojnë më shumë në inovacione se firmat e mëdha, sidoqoftë ato janë të matura (Audretsch, 1995). Në të vërtetë, firmat e vogla dhe të mesme shpesh konsiderohen të jenë më inovative se ato të mëdhatë për shkak të fleksibilitetit dhe vullnetit të tyre për rrugë të reja (Davis, 1991). Për realizimin e objektivave të tyre firmat duhet t’u kushtojnë rëndësi të veçantë inovacioneve, megjithatë sfidë e madhe për to është gjetja e burimeve të financimit të projekteve të tilla që nxisin dhe i realizojnë inovacionet në nivel të tyre. Në këtë punim do të fokusohemi te definimi dhe kuptimi i inovacioneve, roli dhe rëndësia e inovacioneve në plotësimin e nevojave të konsumatorëve, ndikimi i inovacioneve dhe menaxhimi i tyre në realizimin e sukseseve të firmave, me qëllim të tejkalimit të sfidave globale ekonomike.

Fjalë kyç: *inovacion, firmë, konsumator, konkurrencë, sfida globale, sukses.*

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE DHE ARSYEJA E LARGIMIT TË INVESTITOREVE, RASTI I KOSOVËS

Ramë Hajraj

Universiteti “ Haxhi Zeka “
Email: ramehajraj@yahoo.com

Ardita Uka

Universiteti “ Hasan Prishtina “
Email: Uka-ardita@live.com

Abstrakt

Punimi shkencor do të fokusohet në analizën e investimeve të huaja direkte në Kosovë dhe arsyeën e largimit të investitorëve nga Kosova .

Studimi ynë ka këtë metodologji të hulumtimit, kryesisht e përberë nga të dhënat primare dhe sekondare (të dhënat primare janë të nxjerra nga anketimi i drejtëpërdrejtë që kemi bërë me qytetarët për të nxjerrë informacione nga ata se sa janë bërë investime në Kosovë dhe cilët janë faktorët që i largojnë investitorët nga Kosova dhe të dhënat sekondare që i kemi nxjerrë nga studimet shkencore të së njëjtës tematikë, institutet e profilizuara për studime të avancuara, agjencitë e ndryshme statistikore). Ky studim është fokusuar në të dhënat që i kemi nxjerrë nga institutet e profilizuara për hulumtime, të cilat u përkasin kryesisht institucioneve publike në Kosovë, për të nxjerrë të dhëna për vinë e investimeve në Kosovë, për të analizuar rënien dhe rritjen e investimeve, gjithashtu përmes paraqitjes empirike ne do të gjejmë faktorët që ndikojnë në uljen e këtyre investimeve në Kosovë .

Si përfundim i këtij punimi shkencor ne mund të themi se studimi ynë ka analizuar kryesisht problematikat që ka Kosova në përmisimin e pozicionit të indeksit të investimeve .

Fjalë kyç: *investim, agjenci, institut, infrastrukturë, faktor.*

ROLI I BORXHIT PUBLIK NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

Roberta Bajrami, PhD

Kolegji AAB
roberta.bajrami@aab-edu.net

Abstrakt

Qëllimi kryesor i këtij punimi është shqyrtimi i ndikimit afatshkurtër dhe afatgjatë të borxhit publik në raport me rritjen e GDP – së të vendit në periudhën kohore 2008 deri 2016 dhe efektet e këtij borxhi në periudha afatgjata për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Huluntimet e deritanishme për raportin e borxhit publik dhe GDP – së tregojnë se pragu ku borxhi publik jep rezultate pozitive në rritjen e GDP-së për vendet në tranzicion është 70-80% dhe nga ky nivel e më lart ka efekte negative në rritje ekonomike. Duke u bazuar në këto të dhëna ky punim do bëjë diskutimin për Kosovën duke analizuar prapun e deritanishëm të borxhit publik dhe efektet e tij në të ardhmen.

Metodologjia e cila do përdoret në këtë punim është nëpërmjet metodës empirike. Analiza e të dhënave do bëhet me anë të programit STATA dhe do të tregojë prapun në të cilin Kosova është aktualisht me borxh publik. Rezultati nga VECM tregon se ekziston një ekuilibër afatgjatë midis variablave, kurse duke përdorur GMM për të shqyrtuar raportin e borxhit publik dhe ndikimit në GDP rezultatet tregojnë se të gjitha variablat ndikojnë në rritjen bruto të produktit vendor.

Fjalë kyç: *borxh publik, GDP, zhvillim ekonomik, VECM, GMM.*

STRATEGJITË E MARKETINGUT NË ZHVILLIMIN E PRODUKTEVE TË REJA

Rrezarta Gashi

Kolegji AAB

E-mail: rrezartag@gmail.com

Abstrakt

Në ditët e sotme, inovacionet e shumta në produkte të reja kanë bërë që kompanitë të kenë strategji të ndryshme në zhvillimin e tyre dhe pozicionim më të mirë në treg. Strategjitë e marketingut të cilat përdoren për zhvillim të produkteve të reja luajnë rol të rëndësishëm edhe për zhvillimin e kompanisë, sidomos duke u bazuar në atë se konkurrenca është çdo herë e më e egër.

Implementimi i suksesshëm i strategjive është i një rëndësie të madhe për biznesin dhe zhvillimin e tij ndër faza dhe kohë si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe për ato në zhvillim. Organizatat e suksesshme angazhojnë procesin e planifikimit strategjik në marketing për të shfrytëzuar fuqitë e tyre me qëllim që të sigurojnë mallrat dhe shërbimet që kënaqin nevojat dhe dëshirat e konsumatorëve (L.Elrazi, 2010, 14). Edhe pse të gjitha ndërmarrjet mundohen që të kenë sukses me plasimin e artikujve të rinj në treg, disa prej tyre edhe mund të dështojnë, ku si pasojë është mosgjëja e strategjisë adekuate. Në këtë artikull do të trajtohet rëndësia e menaxhimit të strategjive të marketingut për zhvillim e produkteve të reja, duke përfshirë këtu edhe tregun e Kosovës si treg në zhvillim.

Fjalë kyç: *strategji, marketing, produkte të reja, zhvillim, treg.*

NDIKIMI I PROCESVE DEMOGRAFIKE NË QËNDRUESHMËRINË EKONOMIKE TË KOSOVËS

Prof. ass. dr. Sami Behrami

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

E-mail: samibehrami@gmail.com

Abstrakt

Faktorët demografikë janë elemente të rëndësishme për përcaktimin e drejtimit të zhvillimit socio-ekonomik të një vendi e me këtë rast edhe për qëndrueshmërinë në zhvillimin ekonomik të vendit. Komponentët demografikë janë bazë për progres, mbijetesë dhe zhvillim për të gjitha shoqëritë/njerizimin dhe injorimi i kësaj të vërtete themelore herët a vonë sjell rezultate negative edhe në sferat tjera të jetës. Struktura ekonomike e popullsisë është në lidhje shkak-pasojë me strukturat tjera demografike, por edhe me ato socio-ekonomike, kulturore me të gjitha kushtet, ndryshimet dhe pasojat. Punimi trajton rolin dhe rëndësinë e zhvillimeve demografike në qëndrueshmërinë ekonomike të Kosovës në të ardhmen, mbështetur në të dhënat e publikimit “Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061”. Pyetja themelore në të cilën është orientuar kjo analizë socio-demografike është: si ndikon situata dhe zhvillimet demografike në qëndrueshmërinë ekonomike në Kosovë dhe cilat janë implikimet e tyre në një nga strukturat më të rëndësishme të popullsisë që është struktura ekonomike, ose a mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik me mungesë të qëndrueshmërisë të zhvillimit demografik. Sipas parashikimit të popullsisë së Kosovës 2011-2061, Kosova në të ardhmen do të ballafaqohet me sfida më serioze për shkak të tendencave të pavolitshme demografike të cilat do të rrezikojnë qëndrueshmërinë demografike, e e cila pa dyshim se do të përcillet edhe me paqëndrueshmëri në sferat tjera të jetës, duke përfshirë edhe zhvillimin ekonomik.

Fjalë kyç: *proces demografik, strukturë ekonomike, zhvillim i qëndrueshëm.*

NDIKIMI I EKSPOZIMIT TË PRODUKTEVE NË VENDIMIN E KONSUMATORIT PËR BLERJE

Prof. ass. dr. Shaip Bytyçi

Kolegji AAB

E-mail: shaip.bytyqi@universitetiaab.com

Ermira Bytyçi

E-mail: ermirabytyqi@live.com

Abstrakt

Shitja është një mënyrë e komunikimit ndërmjet blerësve dhe shitësve, shpesh një ballafaqim ballë për ballë i projektuar për të ndikuar në vendimin e një grupi personash apo një personi të vetëm për të kryer një blerje. Merchandisingu - ekspozim i produkteve janë të gjitha aktivitetet të cilat përmirësojnë komercializimin e produktit, qëllimi i të cilit është tërheqja e vëmendjes të konsumatorit drejt produktit, kur konsumatori gjendet në vendin e shitjes. Prezantimi vizual është arti dhe shkenca për paraqitjen e produkteve në mënyrë më tërheqëse. Metoda vizuale është “gjuha e një dyqani”, është një mënyrë e komunikimit me klientë nëpërmjet imazhit të produktit. Edhe pse metoda vizuale është e lidhur shpesh më pakicë, ka shumë mënyra për t’i paraqitur shumë lloje të produkteve në avantazhin e tyre më të mirë.

Fjalë kyç: *ekspozim, produkt, blerje, konsumator.*

GAINING OF THE RIGHT OF OWNERSHIP IN A DERIVATIVE AND ORIGINAL WAY AS A CHALLENGE IN ECONOMIC DEVELOPMENT

Shemsije Demiri, PhD

Internacional University of Struga

Email: sh.demiri@eust.edu.mk

Rudina Kaja PhD

International University of Struga

E-mail: sh.demiri@eust.edu.mk

Abstract

This paper is about the right of ownership in general terms since its source in the Roman law, which is the starting point for all subsequent legal systems. Starting my this point, gaining the right of ownership is treated by the historical perspective, including literature and studies of local and international aspect, as well as in legal aspects of civil codes which devote respective countries cited in the paper. Among the ways for gaining ownership are chosen the most important and the most known ways which are the same ways as they existed during the system of the Roman law. Mainly, there are given their historical characteristics described by the consulted authors and on the other hand the regulation which is made by relevant laws in order to compare. By the multifaceted treatment, which is made by the lawyers of all times, one can see the dimension and variety of topics regarding property, in particular of those for gaining property titles, reviewed separately by all legal systems. Their classification takes into account the main division which aims to demonstrate the background of ownership, being either by source or derived, and thus the measures taken to achieve the ultimate goal of gaining the right of ownership, depending on the required conditions. Besides the Albanian terminology, there is given the Roman terminology as well for important titles and some action which deal with possessive procedures addressing the issues and the necessary proceedings until concluding the dispute.

Keywords: *receiving the right of property, items, real estate, chattels, prescription, and loss of property.*

PUBLIC-PRIVATE PARTNERSHIPS AS A FORM OF AGRIBUSINESS INCUBATORS

Prof. Dr. Šemsudin Plojović

University of Novi Pazar

Email: s.plojovic@gmail.com

Abstract

In this paper, the authors are exploring the possibilities of development and support of small agricultural households using the model of business incubators. Business incubators are usually treated in the literature as the sum of business start-ups that in one place receiving consulting services in the development of their business. However, in case of small agricultural households, such an organization is not possible. The authors, therefore, in this paper are researching needs for consulting services of small farming households and firms involved in processing agricultural products. Based on the collected findings, the authors have formed a business incubator model that would fulfill its basic function, but that would not gather the members in one place but to gather them at the same virtual location. The paper presents the tools and applications that would be part of a business incubator in agribusiness and the entire model of virtual agribusiness incubator. Research and development of models show that this kind of project in the application can provide additional support for the development of agribusiness with the involvement of institutions from the level of local and national authorities. That inclusion of employees in the services related to economic development and agriculture as well as other circumstances related to the business can be formed through public private partnership. In this all included stakeholders are wining: small agricultural firms get consulting, local and national governments are accomplishing better employment and tax statistics, and market gets products of higher quality.

Keywords: *business, incubators, services, agrobusiness.*

EDUCATION AND HUMAN RESOURCE DEVELOPMENT AS A KEY POTENTIAL IN TOURISM BUSINES MANAGEMENT

PhD. Shqiponja Nallbani

Kolegji AAB

Email: shqiponja.nallbani@aab-edu.net

Abstract:

Today, tourism is considered as one of the dynamic development activities and as such is one of the most powerful industries in the world. Tourism has a major impact on the economic and social development of many countries, especially developing ones, and is seen as one of the most important sources of income, employment opportunities, economic diversification, and environmental protection and the promotion intercultural exchanges. Potential or other indicator that affects the sustainable development of tourism is the education and human resource development. Given the natural and human resources prosperous managing the touristic business appears to be necessary. Based on this situation, the paper aims to provide some study programs which will create (educate) and develop modern manager in tourism business management. In the Kosovo context, this task is likely to be realized only if higher education study programs will transform appropriately and become a segment that creates appropriate managers to operate successfully in the current business environment resort. Therefore, the proposal of contemporary models for the specific educational Programs to create managers in the field of tourism, consider that would encourage the efficient management of the region, making tourism the main supporter for the domestic economy.

Key words: Tourism, human resources, manager, higher education, study program, economy.

THE IMPORTANCE OF MARKETING IN PUBLIC SECTOR

Msc. Stela Mara

Universiteti “Aleksander Moisiu”, Durres
e-mail: stela_mara@info.al

Msc. Roland Shahini

Universiteti “Aleksander Moisiu” Durres
e-mail: landshahini@yahoo.com

Abstract

Marketing has an important role in the creation and the development of a business, we can see this role not only in the private sector but even in the public one. Public institutions are crucial to our society so if we mention here the Health Care sector, we can say that it has a significant impact on the citizens. This is one of the reasons why everyone asks for more investments and innovation in this field. The purpose of this study is to understand the importance of marketing in the public sector, especially in the Health Care one. We want to define the expectations and the perceptions of the patients about the services in the Health Care sector through this study. Methodology used in this study combined the primary and the secondary evidence. This study consists of two parts: the first one based on the theory of the relevant literature used to support this topic and the second one based on a survey where 200 people were asked about the services of Health Care. Questionnaires’ were made in Durres and the data collected is based on SERVQUAL technique.

The results and the conclusions of this thesis are significant for our society. It is obvious that it does exist a huge gap between what patients expect from the Regional Hospital of Durres and what it is really offered. The expectations are higher graded on a growing 1-7 scale, they are over 6.

Keywords: *Marketing, Public Sector, Patient, SERVQUAL technique, Services, Quality.*

FOREIGN DIRECT INVESTMENTS AND KOSOVO DIASPORA

MA. Veton Xhemaj

Unversiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"

Email: veton-xhemaj@hotmail.com

Abstract

Foreign direct investment is the key to the economic development of a country because they increase economic growth, economic stability, employment and at the same time make a country partially independent of imports.

Kosovo after the war is set for a free market, where foreign investors have the opportunity to invest in our country, but unfortunately, foreign direct investments are in small numbers because of the fragile political situation, the low level of Security, corruption and electricity problems.

Whereas, when talking about Kosovo Diaspora, we should point out that remittances are the main pillars for a better welfare for Kosovar families. Diaspora incomes have not generated employment and economic development due to the lack of domestic production. Revenues from the diaspora are going to benefit only countries from which Kosovo imports the bulk of the goods.

Our institutions should focus on providing the opportunity for our diaspora to invest in Kosovo, small and medium-sized enterprises, and not even big ones. These investments would have the effect of reducing the export of money to other countries, especially in Serbia.

Combining foreign direct investment from investors from other countries and our diaspora will revive the Kosovo's economy, reflect economic stability and prosperity for Kosovo's citizens.

Keywords: *Investments, Kosovo, Diaspora, domestic production.*

RËNDËSIA E MARKETINGUT NË ZHVILLIMIN E PAZARIT TË KRUIJËS

Xhulja Kurti

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
xhulja1993@hotmail.com

Anxhela Lamaç

Universiteti “Aleksander Moisiu”, Durrës
anxhelalamaj@gmail.com

Lorena Allko

Universiteti “Aleksander Moisiu”, Durrës
lorenaallko@gmail.com

Abstrakt

Një ndër çështjet më të rëndësishme në evoluimin e turizmit është përpjekja e organizatave kombëtare për të siguruar rritje dhe fitime duke maksimizuar kënaqësinë konsumatore. Shumë i rëndësishëm është edhe marketingu që përdoret për të promovuar traditën, kulturën dhe mbi të gjitha historinë e vendit tonë, që ndikojnë në zhvillimin e turizmit. Në Shqipërinë tonë ka plot qytete kyçe që mbajnë gjallë prezantimin përballë të huajve të një historie mbase të ndryshme nga ato të vendeve të tjera. Për këtë ekziston edhe shprehja: “ Kush nuk ka vizituar Krujën, nuk ka vizituar Shqipërinë”. Po të nisemi nga analizimi i pyetësorëve të plotësuar nga tregtarët e pazarit të Krujës tregon se ata duhet të njohin forma të ndryshme të marketingut. Qëllimi kryesor i këtij kërkimi fokusohet te njohja e tregtarëve me forma të ndryshme të marketingut siç janë përdorimi i marketingut si strategji shitjeje dhe rëndësia e marketingut në zhvillimin e turizmit në qytetin e Krujës.

Gjatë realizimit të këtij kërkimi pritet që marketingu të ketë një rol thelbësor në krijimin e një ekspozimi atraktiv të produkteve tradicionale dhe historike për zhvillimin e pazarit të Krujës.

Fjalë kyçe: *turizëm, marketing, promovim, pazar i Krujës.*

AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE DHE ROLI TYRE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI, QASJE KRAHASUESE

Albana Pasjaqa, PhD

Kolegji AAB

Email: albana.pasjaqa@aab-edu.net

Ylber Prekazi, PhD

Kolegji AAB

E-mail: ylber.prekazi@aab-edu.net

Abstrakt

Investimet e huaja direkte konsiderohen mjaft të rëndësishme dhe një nga shtyllat kryesore në zhvillimin ekonomik të vendit dhe padyshim që sjellin efekte pozitive në ekonominë e vendeve në të cilat investojnë.

Investimet e huaja direkte mundësojnë përparimin dhe hapjen e ekonomive në nivel ndërkombëtar, duke ndihmuar në zhvillimin ekonomik të vendit pritës . Gjithashtu vlen të theksohet se IHD-të mundësojnë krijimin e vendeve të reja të punës dhe ndikojnë në një cilësi më të lartë me ç'rast ofrojnë paga më të kënaqshme dhe kushte me të mira për punëtorët. Ky studim do të japë një gjendje reale të ndikimit dhe rolit të investimeve të huaja direkte në Kosovë dhe Shqipëri. Qëllimi kryesor i kësaj teme ka të bëjë me atë se cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e të investuarit në Kosovë dhe Shqipëri.

Investimet e huaja direkte, përveç anës pozitive kanë gjithashtu edhe “mangësi” të cilat i shoqërojnë duke përfshirë problemet gjuhësore dhe kulturore, mundësinë e dështimit që bën investitorët të kenë kujdes të madh para se të investojnë në një vend dhe ajo që është më e rëndësishmja, marrëdhëniet tregtare që ka vendi ku investitorët dëshirojnë të investojnë me shtetet fqinje luan një rol vendimtar për të investuar.

Fjalë kyç: *investime të huaja direkte, Kosovë, Shqipëri, zhvillim ekonomik.*

INOVACIONET SI FAKTORË NË ZHVILLIMIN E NVM-ve

Rifat Haxhija

Kolegji AAB,
rifat.haxhija@aab-edu.net

Visar Qarkaxhija

Kolegji AAB,
visar.qarkaxhija@aab-edu.net

Abstrakt

Biznesi i vogël dhe i mesëm zë numrin më të madhë, mbi 99% të numrit të përgjithshëm të bizneseve në Kosovë, ai vepron në një presion të madh të konkurrencës, andaj bizneset janë të shtyra që në mënyrë të vazhdueshme të jenë në kërkime të procesit të prodhimit apo ofrimit të produkteve-shërbimeve të reja. Inovacioni luanë rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe performancën e kompanisë. Objekt studimi i këtij punimi është që të shqyrtojë rëndësinë e inovacionit, sipërmarrjes dhe aktiviteteve të menaxhimit strategjik në sektorin e NVM-ve në Kosovë. Objektiva finale afatgjate është zhvillimi i kapaciteteve për zhvillimin ekonomik lokal, për të përmirësuar të ardhmen ekonomike dhe cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët.

Ky është një proces në të cilin sektori i NVM-ve, institucionet publike, partnerët e sektorit privat dhe atij joqeveritar duhet të punojnë së bashku për të krijuar kushte më të mira për rritjen ekonomike. Në këtë material do të përdoren kryesisht të dhënat nga burimet sekondare, nga libra të botuara, gazeta, publikime dhe artikuj të ndryshëm, të dhëna nga interneti, si dhe interpretimi i analizave dhe hulumtimeve për NVM-të e Kosovës dhe rajonit. Si pyetje do të jetë: A ndikon aplikimi i inovacionit nga NVM-të në zhvillim e kapaciteteve të tyre dhe atë të ekonomisë? Gjetjet nga kjo pyetje kërkimore do të ipen në fund të punimit, tek pjesa e konkluzioneve.

Fjalë kyç: *Inovacioni, biznesi i vogël dhe i mesëm, zhvillimi ekonomik, rritja ekonomike, ekonomia joformale.*

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

33(496.51)“2017”(063)
327(496.51:497)“2017”(063)

Book of abstracts : International Scientific Conference : The economic stability of the Balkan's countries and integration challenges 03 June 2017, Pristina. – Prishtinë : Kolegji AAB, 2017. – 54 f. ; 21 cm.

ISBN-978-9951-494-66-3